Kronikë

Shpërthim tritoli në banesën e tregtarit Altin Lamçe në Lushnje! E treta herë që i vendoset lëndë plasëse

Një shpërthim i fortë tritoli ka tronditur Lushnjen këtë mbrëmje. Shpërthimi ka ndodhur për herë të tretë në një banesë në lagjen "18 Tetori" në të cilën dikur jetonte tregtari Altin Lamce

Pamje nga vendngjarja

Redaksia
24 Dhjetor, 22:39 | **Përditësimi: 24 Dhjetor, 23:46**

Share

Një shpërthim i fortë tritoli ka tronditur Lushnjen këtë mbrëmje. Shpërthimi ka ndodhur për herë të tretë në një banesë në lagjen "18 Tetori".

Për herë të parë tritoli iu vendos në datën një nëntor 2022, me pas në 31 dhjetor 2022, natën e vitit të ri.

Në banesë jetonte Altin Lamce, tregtar në tregun fruta perimeve Lushnje. Prej natës kur ndodhi shpërthimi gjatë vitit të ri ata u larguan dhe nuk u kthyen më.

LEXO EDHE:
VIDEO/Makina përplaset me motorin në Lushnje, plagoset çifti i bashkëshortëve! Gruaja në gjendje të rëndë

Banesa është në pronësi të një tjetër shtetasi Arben Turkut kunati i tij i cili është në emigrim në Angli.

Lënda plasëse dyshohet se u hodh nga autori në ecje nga rruga drejt oborrit të shtëpisë. Janë thyer xhamat dhe dyert e kësaj banese ndërsa në oborr është hapur një gropë e madhe.

Në banesë aktualisht nuk jeton me asnjë njeri për shkak të vendosjes së tritolit më herët. Një vit me parë jetonin 5 persona, çifti Lamçe me dy fëmijët e mitur 12 dhe 15 vjeç dhe nëna 77 vjeçe.

Altin Lamçe nuk rezulton të jetë person me precedentë penal. Policia po punon për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorëve ndërkohë po shihen edhe kamerat e banesave te lagjes.

B.K/Shqiptarja.com

TAG: shperthim me tritol | tritol | lushnje

Komento

Komente

Qytetari: 25/12/2023 02:53

Kur plas ne Lushnje tritoli, nuk imagjinohet dot si mund te jete gjendja ne qytetet e tjera! Mjere ne qe kemi ngelur ne Shqiperi!

Përgjigju

Gripi: 25/12/2023 10:51

Lushnja eshte qytet me ngarkese te larte kriminaliteti keshtu qe mos flit kot. Derisa policia e kriminalizuar nuk ka gjetur dot dy herdt e para se kush qendron pas ketij akti terrorist, atehere ky horr qe e ben do e beje prape. Turp i madh

Ndalohet rrepetësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ka qënë për ju 2023-shi?

Vit i mirë | Vit i keq | Si të tjerët

Lajme të tjera

Shkrumbohet mobilieria në Lushnjë, shkak dyshohet shkëndija elektrike
Yrjet Saliasi
17 Dhjetor, 09:47

Digjet banesa në fshatin Bubullimë të Lushnjës, ndërron jetë 82-vjeçari! Shpëton bashkëshortja e tij
Yrjet Saliasi
14 Dhjetor, 07:34

VIDEO/ Aksident në Golem të Lushnjës, ndërron jetë këmbësori, shoqërohet në polici shoferi i makinës
11 Dhjetor, 18:30

Transport i emigrantëve të paligjshëm për të kaluar kufirin dhe shkelja e masës së sigurisë, arrestohen 2 persona në Lushnjë
10 Dhjetor, 14:06

'Kapriçiot' e motit dëmtojnë pataten e vjeshtës në fushat e Divjakës, fermerët: E shesim me 45 lek/kg, nuk mbulojmë sot as koston
Yrjet Saliasi
3 Dhjetor, 16:19

FOTO + VIDEO/ Tritol lokalit në rrugën 'Sali Butka' në Tiranë, dëme të shumta materiale! Dëmtohen edhe dy biznese ngjitur
28 Nëntor, 09:16

VIDEO/Lushnjë, përkujtohet Dita e Ngritjes së Flamurit
27 Nëntor, 20:38

I doli qeni nga oborri i banesës dhe kafshoi 33-vjeçaren gjermane, në hetim i riu në Lushnjë
27 Nëntor, 11:44

Rruga Gosë -Vilë-Bashtovë pa barriera e sinjalistikë, dëmtohet një vit pas rikonstruksionit! Shoferët: Ka marrë jetën e 4 njerëzve, duhet ndërhyrje
26 Nëntor, 17:04

Kastravecat me pesticide në Lushnjë, Gjermania kthen 24 tonë! AKU: Do asgjësohen
24 Nëntor, 17:28

Lushnjë/ Makina fluturon disa metra në ajër dhe përplaset me betonin e nënkalimit, shpëton mrekullisht drejtuesi i mjetit (VIDEO)
23 Nëntor, 19:03

Aksident në aksin Lushnje-Fier, makina përfundon në kanal! Shpëton mrekullisht babai me tre fëmijët e mitur
23 Nëntor, 14:06

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje